



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
QENDRA SPITALORE UNIVERSITARE "NËNË TEREZA" TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME

MIRATUAR

Ogerta Manastirliu

Drejtor i Përgjithshëm

PROGRAMI I TRANSPARENCËS SË QSUT

I. HYRJE

Në përputhje me nenin 7 të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” përgatiti programin e saj të transparencës. Ky program përcakton kornizën ligjore të veprimtarisë së QSUT në kuadër të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” (LDI).

Ky program vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës QSUT ndërton dhe rrit transparencën në punën e tij institucionale, dhe synon të kryejë transparencën e veprimtarisë së punës së saj, nëpërmjet pasqyrit të detajuar të tij në faqen zyrtare www.qsut.gov.al si dhe në mjediset e pritjes së publikut.

Programi i transparencës pasqyrohet në rubrika, tekste/përmbajtje, afat kohor për bërjen publike të tij, mënyrën e bërjes publike si dhe strukturën përkatëse e cila prodhon ose administron dokumentin. Shih në vijim Tabelën Përmbledhëse të Programit të Transparencës së QSUT.

Dokumentacioni i bërë publik, do të jetë i përditësuar në formë e përmbajtje sa herë vlerësohet e nevojshme. Faqja zyrtare e QSUT www.qsut.gov.al është ndërtuar në formë të tillë që mundëson informacion për publikun dhe në format lehtësisht të kuptueshëm dhe kjo realizohet në disa rubrika. Konkretisht në rubrikën “Rreth nesh” dhe “Shërbimet mjekësore” gjendet informacion rreth kuadrit ligjor, organizimit dhe drejtimit të punës në QSUT si dhe informacione më të detajuara rreth shërbimeve mjekësore të ofruara. Më tej në rubrikën “Për pacientët dhe familjarët” dhe “Shëndeti juaj” mund të gjenden informacione të detajuara rreth orarit, vendndodhjes, dokumentacionit të nevojshëm për marrjen e shërbimeve shëndetësore, të drejtat dhe detyrimet e pacientit në spital, si dhe këshilla të ndryshme edukuese.

II. PARIME TË PËRGJITHSHME

Parimet kryesore në të cilat mbështetet Programi Transparencës së QSUT -së janë:

1. “E drejta për informim” është e drejtë Kushtetuese e parashikuar në nenin 23 të saj, e aksesueshme nga të gjithë pa asnjë përjashtim.
2. Prezumimi i publikimit maksimal të të dhënave: QSUT-ja ushtron funksione publike, për rrjedhojë informacioni që rrjedh nga veprimtaria e tij publikohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Shërbimi mjekësor në QSUT ushtrohet në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kodin e Punës, të Ligjit Nr. 8485, datë 12.05.1999 për “Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të Ligjit Nr. 9106, datë 17.07.2003 “Për shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit Nr. 147/2014 “Për shërbimin e urgjencës mjekësore”, Ligjit Nr. 10383, datë 24.02.2011 “Për Sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit Nr.131/2012 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar”, Ligjit Nr.7815, datë 20.4.1994 “Për barnat”, Ligjit Nr.9323, datë 25.11.2004 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, Ligjit Nr. 89/2014 “Për pajisjet mjekësore”, Ligjit Nr.8025, datë 9.11.1995 “Per mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”, Ligjit Nr.7761, date 19.10.1993 “Për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse”, Ligjit Nr.9952, datë 14.7.2008 Për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it, Ligjit Nr. 44/2012 “Për shëndetin mendor”, Ligjit Nr. 8615, datë 01.06.2000 “Për Urdhrin e Mjekëve në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit Nr.9718, datë 19.4.2007 “Për urdhrin e infermierit në Republikën e Shqipërisë”, si dhe akte të tjera ligjore e nënligjore që lidhen me veprimtarinë e saj.
4. Informacioni përshtatet në gjuhë të qartë e të kuptueshme.
5. Organ mbikëqyrës i procedurave të informimit publik është Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale” (këtej e tutje KDIMDP).
6. Rishikimi i programit të transparencës bëhet sipas së njëjtës procedurë, përmes së cilës është bërë miratimi i tij.
7. Informacioni publik pa kërkesë duhet të jetë:
 - i plotë;
 - i saktë;
 - i përditësuar;
 - i thjeshtë në konsultim;
 - i kuptueshëm;
 - lehtësisht i aksesueshëm;
 - i pajtueshëm me dokumentet origjinale në posedim të autoritetit publik.

III. INFORMACIONI QË BËHET PUBLIK PA KËRKESË

Bazuar në programin e transparencës të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i QSUT, në faqen www.qsut.gov.al dhe në mjediset e pritjes së publikut, QSUT vendos në dispozicion të publikut informacionet e mëposhtme:

- Strukturën organizative të QSUT;
- Tekstet e plota të ligjeve, të akteve nënligjore, të kodeve të sjelljes, të konventave që janë ratifikuar, dokumente politikash, të manualeve ose dokumentave të tjera të lidhura me ushtrimin e funksioneve të tij dhe që prek publikun e gjerë;
- Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës;
- Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit;
- Të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime;
- Mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera audituese, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së institucionit;
- Të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit. Në ato raste kur autoriteti publik vetëfinancohet nga tarifat e licencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej tij, bëhen publike edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara;
- Informacion për procedurat e prokurimit publik, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, “Për prokurimin publik”, që kryhen për llogari të saj, duke përfshirë: listën e kontratave të lidhura, shumën e kontraktuar, palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara, informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme;
- Informacion për shërbimet që i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit, një përshkrim të kategorive dhe formave të ndihmës shoqërore, subvencioneve të dhëna nga autoriteti publik dhe të procedurave për t’i përfituar ato, informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh, çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga autoriteti publik;
- Çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik, procedura, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të QSUT, një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë;
- QSUT-ja, krijon dhe arkivon një kopje digjitale të faqes zyrtare të tij në internet, të plotësuar me informacionin që kërkohet në programin e miratuar të transparencës, si dhe për metodat, mekanizmat dhe periodicitetin e publikimit të informacioneve publike, të cilat vihen në dispozicion të publikut pa kërkesë;

- Aktet që përmbajnë rregulla, norma apo kufizime të drejtave dhe lirive themelore të individit, si dhe me efekt të drejtpërdrejtë për ta, bëhen publike me anë të afishimit apo postimit në faqen zyrtare të internetit, brenda 48 orëve prej miratimit të aktit nga QSUT-ja.

Informacioni i publikuar sipas kësaj skeme, përditësohet sa herë ai ndryshon.

IV. TABELA PËRMBLEDHËSE E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS SË QSUT

Kategoritë e informacionit publik pa kërkesë	Baza ligjore	Dokumenti/Përmbajtja	Afati kohor për publikim	Mënyra e publikimit	Struktura përgjegjëse
Përshkrim i strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik.	Neni 7/1/a/d	Faqja zyrtare e QSUT Struktura organizative Drejtimi institucional Drejtimi Mjekësor	1)Menjëherë pas botimit në fletore zyrtare, 2)Referojun i pikës 3 të nenit 7, ose 3) Menjëherë pas miratimit të aktit nga titullari..	Organigram Drejtimi Institucional Drejtimi Mjekësor	Drejtoria e Burimeve Njerëzore
Akte ndërkombëtare ligje; akte nën ligjore; dokument politikash; dokument tjetër.	Neni 7/1/b	Shërbimi mjekësor në QSUT ushtrohet në përputhje me: -Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, - Kodin e Punës, - Ligjin Nr. 8485, datë 12.05.1999 për “Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së		Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë Kodi I punës Ligj_8485_1 2.05.1999	Drejtoria Juridike

	<p>Shqipërisë”,</p> <p>- Ligjin Nr. 9106, datë 17.07.2003 “Për shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë”,</p> <p>- Ligjin Nr. 147/2014 “Për shërbimin e urgjencës mjekësore”,</p> <p>- Ligjin Nr. 10383, datë 24.02.2011 “Për Sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”,</p> <p>- Ligjin Nr.131/2012 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar”,</p> <p>- Ligjin Nr.7815, datë 20.4.1994 “Për barnat”,</p> <p>- Ligjin Nr.9323, datë 25.11.2004 “Për barnat dhe shërbimin</p>		<p>Ligj_9106_1 7.07.2003</p> <p>Ligj_147- 2014_30.10. 2014</p> <p>Për Sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë</p> <p>Ligj_131- 2012_27.12. 2012</p> <p>Ligj_7815_2 0.04.1994</p> <p>Ligj_9323_2 5.11.2004</p>	
--	--	--	--	--

	<p>farmaceutik”,</p> <p>- Ligjin Nr. 89/2014 “Për pajisjet mjekësore”,</p> <p>- Ligjin Nr.8025, datë 9.11.1995 “Per mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”,</p> <p>- Ligjin Nr.7761, date 19.10.1993 “Për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse”,</p> <p>- Ligjin Nr.9952, datë 14.7.2008 Për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it,</p> <p>- Ligjin Nr. 44/2012 “Për shëndetin mendor”,</p> <p>- Ligjin Nr. 8615, datë 01.06.2000 “Për Urdhrin e Mjekëve në Republikën e</p>		<p>Ligj_89- 2014_17.07. 2014</p> <p>Ligj_8025_0 9.11.1995</p> <p>Ligj_7761_1 9.10.1993</p> <p>Përparandali min dhe kontrollin e HIVAIDS-it</p> <p>Ligji për shëndetin mendor</p> <p>Ligji nr.123 për urdhërin e mjekëve</p>	
--	--	--	---	--

		Shqipërisë”, - Ligjin Nr.9718, datë 19.4.2007 “Për urdhrin e infermierit në Republikën e Shqipërisë”, si dhe akte të tjera ligjore e nënligjore që lidhen me veprimtarinë e saj.		Për urdhrin e infermierit në Republikën e Shqipërisë	
Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitim e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës.	Neni 7/1/c/g	Programi I transparences Formulari I kërkesës per informacion Formulari për refuzim të formës së kërkuar të informacionit Formati I zgjatjes së afatit të kthimit të përgjigjes		Shkarko formularin Shkarko formularin Shkarko formularin	Drejtoria e Burimeve Njerëzore
Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit.	Neni 7/1/ç	Faqja zyrtare e QSUT Si të mbërrini në QSUT Si të kontaktoni me ne Kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit		Si të mberini ne qsut Kontakte Koordinatori Znj.Flutura Pulaci Tel: Email:info@qsut.gov.al	Drejtoria e Burimeve Njerëzore

Përshkrim i procedurave të zgjedhjes, kompetencave të funksionarëve të lartë dhe procedura e ndjekjes për marrjen e vendimeve.	Neni 7/1/d	Faqja zyrtare e QSUT Statuti I QSUT		Statuti I QSUT	Drejtoria e Burimeve Njerëzore
Mekanizmat monitorues; raporte auditi; dokumentet me tregues performance	Neni 7/1/dh	Raporti Vjetor 2014		Raporti vjetor	Drejtoria Ekonomike
Buxheti	Neni 7/1/e	Planifikimi I buxhetit per vitin 2015		Buxheti 2015	Drejtoria Ekonomike
Informacion për procedurat e prokurimit.	Neni 7/1/ë	VKM nr.1 date 10.01.2007 Rregullat e prokurimit Publik Ligji_i_konsoliduar_05_02 Per Prokurimin Publik		Rregullat e prokurimit publik Ligji_i_konsoliduar Per Prokurimin Publik	Drejtoria Juridike
Shërbimet e autoritetit për publikun.	Neni 7/1/f	Faqja Zyrtare e QSUT Shërbimet mjekesore te ofruara		Shërbimet mjekesore Shendeti juaj	Zyra e Informacionit dhe Marëdhënieve me Publikun
Paraqitja e mendimeve në hartimin e p/akteve, etj.	Neni 7/1/gj				
Mbajtja e dokumentacionit nga QSUT	Neni 7/1/h	Ligji Nr.9154, datë 06.11.2003 “PËR ARKIVAT ”		Ligji per arkivat	Drejtoria e Burimeve Njerëzore Zyra e

		Norma tekniko profesionale të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë.		Norma tekniko profesionale te shërbimit arkivor	Protokollit
Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 të këtij ligjit nr.119/2014.	Neni 7/1/i	Rregjistri I kërkesave dhe përgjigjeve		Shkarko formularin	Sektori i Informacionit dhe Marëdhënieve me publikun
Informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh.	Neni 7/1/k	Faqja zyrtare e QSUT Informacion për pacientet dhe familjaret		Informacione	Sektori i Informacionit dhe Marëdhënieve me Publikun
Informacione të tjera të dobishme	Neni 7/1/l	Faqja zyrtare e QSUT			Sektori i Informacionit dhe Marëdhënieve me Publikun

V. PUBLIKIMI

Në përputhje me këtë program transparence të miratuar, QSUT-ja vendos në dispozicion të publikut në faqen e tij të internetit [www.qsut.gov.al] dhe në mjediset e pritjes së publikut, kategoritë e mësipërme, në një menu të veçantë të titulluar “Programi i Transparencës”.

VI. MONITORIMI

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale monitoron zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit, duke nxitur parimin e transparencës në punën e autoriteteve publike, veçanërisht duke sensibilizuar dhe informuar për çështje të së drejtës së informimit.

Komisioneri bën rekomandime për autoritetet publike, lidhur me konceptimin dhe zbatimin e programeve institucionale të transparencës.